



Datë/a:	07.06.2018
Për/ Za/ To:	“ROJET E NDERIT” sh.p.k.
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës



Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 04.06.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “ROJET E NDERIT” sh.p.k., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës**”, me Nr. të Prok: 616 17 148 211 nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet si e bazuar kërkesa për ri shqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik “ROJET E NDERIT” sh.p.k. të dt. 04.06.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës**”, me Nr. të Prok: 616 17 148 211 , kundër *Njoftimit për dhënie të Kontratës* te AK -së, të datës 04.06.2018 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të anulohet njoftimin për dhënie të kontratës të datës 04.06.2018 dhe të vazhdojë me ri-vlerësim të tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “**Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës**”, me Nr. 616 17 5437 211 Nr. Brendshëm 616 17 148 211
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Arsyetim

Me datë 04.06.2018, Autoriteti Kontraktues ka bërë njoftimin për dhënie të kontratës pas vlerësimit të ofertave nga ana e anëtarëve për Komision për Ri-Vlerësim ku secili anëtar ka dhënë vlerësimin e tij për çdo kriter të paraqitur në dosje.

Me datë 05.06.2018, Operatori Ekonomik "ROJET E NDERIT" sh.p.k, iu ka lejuar çasja në dokumentacion të të gjitha ofertave lidhur me këtë tender pasi me datë 04.06.2018 ka bërë kërkesë për çasje në dokumentacion të OE te rekomanduar për dhënie të kontratës.

Operatori Ekonomik "ROJET E NDERIT" sh.p.k të dt. 05.06.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës", me Nr. 616 17 5437 211 Nr. Brendshëm 616 17 148 211, kundër Njoftimit për dhënie të Kontratës te AK - së, të datës 04.06.2018 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr.04/L-042, dhe në kërkesat për pjesëmarrje në dosjen e tenderit në të cilin theksohet:

a) Pretendimi: Çmimi i ofruar nga ana e OE fitues nuk i plotëson as për së afërmi kërkesat e AK-së pasi që me një çmim të tillë nuk janë llogaritur të gjitha taksat e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Po ashtu analiza financiare e dorëzuar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës përmban devijime dhe gabime për të balancuar vlerën minus në këtë proces.

I. Baza ligjore për refuzim të kërkesës.

a) **Pretendimi** - Çmimi i ofruar nga OE fitues nuk plotëson nevojat financiare pasi që autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin e analizave financiare të ofertës së OE fitues.

OE ankimor ka sjellur dëshmitë dhe provat së bashku me analizën financiare të paraqitur në kërkesën për ri-shqyrtim, ku ka paraqitur krahasimin e analizës financiare të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës dhe analizën që e ka sjell OE ankimor

K S.A.S. SECURITY	
119.00	Roje
230.00	Paga
241.50	Kontributi shtesë
28,738.50	paga për 1 muaj
344,862.00	paga për 12 muaj
26,469.67	pushimi vjetor
371,331.67	paga+pv
1,042.57	1%shpenzime+fitimi
372,374.24	çmimi total pa tvsh
439,401.60	çmimi total me tvsh
289080	orë në vit
1.52	çmimi për orë me tvsh

Analizë e OE - Rojet e Nderit për gabimet dhe devijimet e analizës së OE i rekomanduar për dhënie të kontratës	
138 roje	Orët totale sipas dosjes janë 289080 pjesim me 12 muaj = 24090 orë në muaj pjesëtuar me 174 orë punë për një punëtor = 138 punëtor e gjithë veprimi në analizë për të balancuar vlerën minus është bërë në numrin e punëtorëve duke minusuar 19 punëtor.
241.50	Kontributi shtesë
33,327.00	paga për 1 muaj

399,924.00	paga për 12 muaj
26,469.67	pushimi vjetor
426,393.67	paga+pv
4,263.94	1%shpenzime+fitimi, në këtë kolon vëreni qartë gabimin që është bërë. Shembull 1% e vlerës totale 426,393.67 është 4,263.94 e jo siç është thënë 1,042.57.
430,657.61	çmimi total pa tvsh
508,175.98	çmimi total me tvsh
289080	orë në vit

Baza ligjore nga AK për analizën financiare

Kërkesat tona ne përshkrimin e çmimit janë të sakta dhe në harmoni me njëra tjetrën. Kemi paraqitur pozitat, kohëzgjatjen e sigurimit, orët ditore dhe vjetore. Autoriteti Kontraktues ka analizuar te gjitha dhe bazuar në të njëjtat janë 99 pozita ditore($26 \times 3 = 78$; $1 \times 16 = 2$; $2 \times 12 = 3$ dhe $16 \times 8 = 16$ ose $289080 \text{ ore} : 365 \text{ dite} = 792 : 8 \text{ ore} = 99$ pozita ditore).

Pozitat e paraqitura ne përshkrim te çmimit nuk përputhen me numrin e punëtorëve qe duhet te angazhohen për shkak te domosdoshmërisë te respektimit te nenit 20.2 te Ligjit te punës sipas te cilit orari i plote i te punësuarit është 40 ore në jave, ndërsa sipas kërkesës tone java ka 7 dite dhe angazhimi i vetëm një punëtori ne një pozite do te ishte $7 \times 8 = 56$ ore.

Bazuar ne këto dispozita ligjore për te gjetur sakte numrin e punëtorëve qe duhet angazhuar pjesëtojmë totalin prej 365 dite me ditët e javes-7 e qe rrjedh se kemi ne total 52.143 jave e qe pjesëtuar me 12 muaj rezulton se mesatarja mujore është 4.345 javë. Kur kjo mesatare shumëzohet me normën prej 40 orë në javë rrjedh $4.345 \times 40 \text{ ore} = 173,80$ e qe d.t.th.se kjo është maksimum mujor i orëve te punës për një te punësuar. Bazuar ne totalin vjetor te orëve nga përshkrimi ynë 289080 rrjedh se totali mujor është $289080 : 12 = 24090$ ore e kur e pjesëtojmë me numrin e orëve për një punëtor $24090 : 173.80 = 138.6$ punëtor ne muaj.

Ne baze te kësaj është i drejte pretendimi i parashtresit te kërkesës se OE-ik i propozuar për dhënie të kontratës ka manipuluar me numrin prej 119 punëtorëve, pasi qe sipas Ligjit duhet angazhuar 138 punëtor.

Poashtu është i bazuar edhe pretendimi se e ka gabuar pozicionin e fitimit+shpenzimit për 1%.

Andaj duke u bazuar në të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara si dhe duke zbatuar dhe respektuar Ligjin për Prokurimin Publik, Rregullat e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik si dhe dipozitave të FDT-së (formularit të dosjes së tenderit), Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitivin e cekur më lartë

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

